

MIRË SE VINI NË FRIBOURG

E SHTUNË, 12 SHTATOR 2026



Programi

Duke nisur
nga ora 10:15

Pritja

Salla komunale Saint-Léonard,
Chemin **Saint-Léonard 1, 1700 Fribourg**
Aksesi në autobus TPF linja 1 stacionet Poya ose
Stade-Patinoire, si dhe me tren BLS S1 stacioni Fribourg-Poya

10:30

Pjesa zyrtaret

- Pritja prej përfaqësuesit të autorizuar
Elias Moussa dhe Këshilli Komunal
- Animacion nga artistë të Fribourg
- Prezantimi i qytetit dhe shërbimeve komunale
- Stenda informacioni të mbajtura prej shërbimeve
komunale dhe pyetje të shpeshta

11:30

Aperitiv dreke / Vizitë në standat e shërbimeve komunale

12:30

Fundi i paradites së pritjes

12:30 - 15:00

Vizitë në këmbë me guidë e qytetit (me regjistrim)

For information in English
Per informazioni in italiano
Para informaciones en español
Para obter informações em português
Türkçe bilgiler için
Për informacionet në gjuhën shqipe
For information in Tigrinya, Ukrainian, Farsi and Arabic
www.ville-fribourg.ch/manifestation-bienvenue

Këshilli komunal i qytetit të Fribourg ka kënaqësinë t'ju ofrojë mirëseardhjen më 12 shtator 2026.

Të dashura banore të reja, të dashur banorë të rinj,

Ju jeni ndër personat të cilët kanë mbërritur në qytetin e Fribourg gjatë vitit të shkuar.
Këshilli komunal dëshiron t'ju urojë mirëseardhjen më të përzemërt. Për këtë qëllim, ai
ju fton në një aktivitet mirëseardhjeje që do të zhvillohet

ditën e shtunë, 12 shtator 2026

duke nisur nga ora 10:15

në Sallën komunale Saint-Léonard

Pjesëmarrja në këtë aktivitet mëngjesi është e lirë dhe falas. Megjithatë, për arsye organi-
zimi, ajo bëhet vetëm me regjistrim. Si rrjedhojë, ne ju lutemi të konfirmoni pjesëmarrjen
tuaj deri më **28 gusht 2026** me ndihmën e buletinit të përgjigjes bashkëngjitur.

Gjatë gjithë paradites, një hapësirë me libra dhe lojëra në dispozicion të fëmijëve do
t'u propozohet prej MEMO, bibliotekës dygjuhëshe me lodra të qytetit. Salla komunale
Saint-Léonard është e aksesueshme për personat me lëvizshmëri të kufizuar. Në rast
nevoje të veçantë ose për çdo informacion tjetër, ne mbetemi në dispozicionin tuaj në
numrin **026 351 76 36** dhe me e-mail te **bienvenue@ville-fr.ch**.

Me kënaqësinë për t'ju takuar në këtë rast, ju lutemi, të pranoni, të dashura
banore të reja, të dashur banorë të rinj, përshëndetjet tona më të përzemërta.

Në emër të Këshillit komunal të qytetit të Fribourg

Përfaqësuesi i autorizuar



Elias Moussa

Sekretari i qytetit



David Stulz

Buletini i regjistrimit

Mbiemri dhe emri

Adresa

Telefoni

E-mail

Aktiviteti i mirëseardhjes (10:30 - 12:30)

☐ Unë marr pjesë në aktivitetin e mirëseardhjes.

Numri i personave:të rriturfëmijë

Aktiviteti do të zhvillohet në frëngjisht, por sipas mundësive, do të ketë dhe një përkthim. Nëse keni nevojë për [një përkthim të njëkohshëm](#), lutemi përcaktoni gjuhën e dëshiruar:

Personat me lëvizshmëri të kufizuar janë të ftuar të na kontaktojnë me qëllim që të lehtësojmë mbërritjen e tyre.

Vizitë e qytetit me guidë (12:30 - 15:00)

☐ Unë marr pjesë në vizitën e qytetit me guidë (falas).

Numri i personave:

Gjuha e dëshiruar për vizitën: frëngjisht, gjermanisht, anglisht, italisht, spanjisht:

Vendi dhe data

Nënshkrimi

Regjistrimi deri të premten, 28 gusht 2026.

Në rast pamundësie pas regjistrimit, lutemi të na informoni.

Me komunikim postar në adresën:

Ville de Fribourg
Bienvenue
Place de l'Hôtel-de-Ville 3
1700 Fribourg

Me e-mail te:

bienvenue@ville-fr.ch

Regjistrim online:

<http://www.ville-fribourg.ch/manifestation-bienvenue>

ose duke skanuar **Code-QR**



Regjistrimi online